



Zyra e personelit

Nr. Prot: 689
Datë: 13.3.2018

Në bazë të Nenit 12 pika 4 të Ligjit për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës Nr. 03/L-149, si dhe Nenit 18 të Rregullores nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil:

Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina" (UP) shpall

KONKURS

Për këtë vend të lirë pune me afat të caktuar në Zyrën e Rektorit të UP:

1. Zyrtar i përkohshëm administrativ (1 punonjës) - në kohëzgjatje prej 01.04.2018 deri më 31.08.2018.

Kandidatët të cilët konkurrojnë për këtë vend pune, përveç kushteve të përgjithshme të parapara me Ligjin Nr. 03/L-149 për Shërbyesit Civilë të Republikës së Kosovës, duhet t'i plotësojnë edhe këto kushte të veçanta:

Të kenë përgatitja shkollore superiore – Fakulteti Filozofik, Filologjisë, Juridik, Ekonomik ose i Edukimit, e nevojshme njohja e punës me kompjuter dhe njohja e gjuhës angleze. Shkathtësi administrative dhe organizative, shkathtësi në komunikim dhe planifikim të punës.

Detyrat – përgjegjësitë kryesore:

- Koordinon punën në zyrën e rektorit në përgatitjen e dokumentacionit të nevojshëm për takimet, udhëtimet zyrtare etj.;
- Regjistron takimet, thirrjet telefonike nga vendi dhe jashtë vendit, mban adresarin (numrat) e telefonave të rektorit dhe prorektorëve dhe të personelit në Universitet;
- I mirëpret vizitorët dhe bashkëbiseduesit në telefon, i përcjell mesazhet nga rektori, prorektorët dhe udhëheqësit tjerë të Universitetit dhe i pranon ato për rektorin, prorektorët dhe udhëheqësit tjerë të UP-ës;
- Sipas nevojës merr pjesë te rektori gjatë përkthimeve nga shqipja në anglisht dhe anasjelltas.
- Informon fakultetet për takimet e Senatit, të Bordit dhe për takimet e tjera që organizohen në Universitet;
- Përkujdeset dhe përgjigjet për ruajtjen e sekretit zyrtar në çështjet e Universitetit;
- Kryen edhe punë të tjera sipas urdhrat të udhëheqësit.

Konkursi mbetet i hapur 7 ditë nga dita e shpalljes në web-in e UP-së, gjegjësisht deri më 19.03.2018. Në zbatim të nenit 11 pika 2 të Ligjit për Shërbyesit Civilë të Republikës së Kosovës, ftohen që të konkurrojnë edhe kandidatët nga komunitetet minoritare në Kosovë.

Dokumentet e kompletuara duhet të dorëzohen në **Rektoratin** e Universitetit të Prishtinës, Rr. "George Bush", p.n. 10 000 - Prishtinë, Republika e Kosovës, **zyra nr. 1**.

Aplikacionet për konkurrim mund të shkarkohen në: www.uni-pr.edu ose mund të merren me rastin e aplikimit për këtë vend pune.

Në procedurën e pranimit të kandidatëve, do të bëhet intervistimi i kandidatëve të cilët i plotësojnë kushtet sipas konkursit.

